

VENDIM
Nr. 190, datë 19.11.2020

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “WENERG” SHA PËR BARRËSIMIN E 100% TË
AKSIONEVE TË SHOQËRISË NË FAVOR TË BANKËS OTP ALBANIA SHA**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; nenit 53, pika 3, të “Kodit të Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 19.11.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 122/1-1 prot., datë 17.11.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me mosdhënien e autorizimit të ERE-s për barrësimin e 100% të aksioneve të shoqërisë “Wenerg” sh.a. në favor të bankës OTP Albania sh.a.,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 158, datë 20.10.2020, vendosi: Shtyrjen me 30 ditë të vendimmarjes së ERE-s për dhënien e autorizimit për barrësimin e 100% të aksioneve të shoqërisë “Wenerg” sh.a., në favor të bankës OTP Albania sh.a.

- Kërkesa drejtuar ERE-s, për marrjen e autorizimit për barrësim të aksioneve, nuk rezultoi nënshkruar nga administratori i shoqërisë, e po ashtu bashkëlidhur kësaj shkrese nuk ishte depozituar autorizim apo prokurë përfaqësimi në emër të saj.

- Gjithashtu, shoqëria nuk kishte depozituar në ERE miratimin paraprak të Autoritetit Kontraktues, në zbatim të nenit 17, pika 1, germa “iii”, të kontratës së koncesionit, ku përcaktohet se çdo transferim tjetër nga koncesionari, ose filiali i tij, për një palë të tretë, të të paktën 51% të aksioneve, në shoqërinë e re, do t'i nënshtrohet miratimit paraprak të Autoritetit Kontraktues.

- Me shkresën nr. 383/11 prot., datë 2.11.2020, ERE iu drejtua shoqërisë me kërkesën për të depozituar dokumentacionin e përfaqësimit të znj. O.H, e po ashtu, për të informuar ERE-n në lidhje me masat e marra nga ana e saj, për të zbatuar detyrimet që rrjedhin nga kontrata e koncesionit dhe për të marrë miratimin paraprak të Autoritetit Kontraktor.

- Në adresën zyrtare të email-it të ERE-s, në datën 17.11.2020, është depozituar kërkesa e shoqërisë, për të marrë në konsideratë shtyrjen e afatit për të kthyer përgjigje në lidhje me informacionin e kërkuar nga ERE me shkresën nr. 383/11 prot., datë 2.11.2020, për shkak të rrethanave të krijuara nga Covid-19.

- Kërkesa e shoqërisë për zgjatje të afatit të depozitimit të dokumentacionit është bërë përpara përfundimit të afatit të vendosur në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 158, datë 20.10.2020.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Zgjatjen me 30 ditë të afatit të shqyrtimit të kërkesës së shoqërisë “Wenerg” sh.a., për dhënien e autorizimit, për barrësimin e 100% të aksioneve në favor të bankës OTP Albania sh.a., me kërkesë të aplikuesit.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR

Petrit Ahmeti